



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-9849/24 datë: 19.04.2024



Npi – 01/158 datë: 26.04.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 26.04.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S Ë -IV- T Ë K O M I T E T I T P Ë R P O L I T I K Ë D H E F I N A N C A
E mbajtur më datën: 26.04.2024 (e premte) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushi, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Besnik Ahmeti drejtor i DBF; Nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni, znj.Gentiana Mehmeti asistente e Kryesuesit të Kuvendit; dhe znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili praktikante.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.03.2024,
2. Raporti tre mujor buxhetor Janar-Mars 2024,
3. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit Nr.Npi-01/75 për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024,
4. Rekomandim nga Komisioni për ndarjen e çmimit “Qytetar Nderi” z.Hartmut Ganzke,
5. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi Komunal të plotësimit të Komisionit për ndarjen e bursave për student,
6. Raport pas mbajtjes së dëgjimit publik për draft-planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit 2024-2026
7. Garancioni i NPL-së
8. Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2024-2026 (pas diskutimit publik).

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.03.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 26.03.2024.**

Pika 2

Raporti tre mujor buxhetor Janar-Mars 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Përshëndetje bazuar në ligjin për financat publike dhe përgjegjësitë jemi të obliguar të prezantojmë reportin 3 mujor për vitin 2024. Materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar kështu që unë do ta lexoj raportin në pikat kryesore sipas tabelave. Në vazhdim lexoi raportin sipas kategorive ekonomike (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, faleminderit për prezantimin. Më la përshtypje te inkasimi i të hyrave vetanake ekzekutivi ka thënë se në vitin e kaluar kemi pas të hyra dhe keni thënë se po qeverisim mirë duke i rritur tatimet. Sivjet a po qeverisni mirë a jo sepse sivjet ka 39% më pak inkasime për periudhën e njejt.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Nuk ka të bëj me rritje të hyrave, por kemi thënë se kjo ka ndodhë për shkakë të faljes së borgjeve, d.m.th minusi është paraqitur për shkakë të faljes së borgjeve që i kemi bërë siq e dini me vendim të Kuvendit. Kështu që fare nuk ka të bëjë me keq qeverisje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë në vitin e kaluar kam paguar mbi 100 euro tatim. Këtë vit më kanë thënë se i kanë vetëm 5 euro për pagesë të tatimit kjo është arsyeja.

z.Kadri Emiri; Përshëndetje, pajtohem me drejtorin por mua më bënë përshtypje shpenzimi i buxhetit me 17% dhe nëse shkon me këtë ritëm atëherë do të thotë që mbërrijmë diku afër 60% dhe kjo është shqetësuse. Por ndodshta me përmirësimin e motit rriten edhe shpenzimet.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Këtu kanë lidhje më shumë pocedurat e prokurimit që bëhen kryesisht në tre muajt e parë të vitit e punët vazhdojnë më vonë.

z.Lumni Amrushi; Përshëndetje, moti më i përshtatshëm është në muajin e 4 dhe 5 sepse nuk është nxehtë. Kemi disa projekte që janë dy vjeqare. Ka disa projekte që janë shpenzuar 20 mijë euro për pak ditë. Unë mendoj se në projektet dy vjeqare mundesh me e rritë përqindjen e shpenzimit të buxhetit.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" me 3 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raporti tre mujor buxhetor Janar-Mars 2024.**

Pika 3

Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit Nr.Npi-01/75 për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ia dha z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Arsyeja se pse e kemi sjellë këtë vendim Npi-01/75 në Kuvend për rishqyrtim është se Ministria e Financave na i ka alokuar disa mjete financiare nga të hyrat sipas këtij vendimi pa na pyetur fare. Dhe tani kanë ndryshuar shumat sipas vendimit dhe ne e kemi sjellë që ta korrigjojmë këtë vendim. Materialin për propozimin që e kemi dhënë ne e keni pranuar me kohë dhe e keni lexuar, por unë po i lexoi shkurtimisht shumat e propozuara dhe pastaj nëse ka pyetje do të përgjigjem. (Shih dokumentin)

z.Përparim Ramusa; Çka dallon ky propozim që e kemi dhënë ju tani nga vendimi i kaluar i Kuvendit? Dhe pyetja e dytë pse nuk është bërë planifikimi për automjetin e ambulancës?

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Thashë në fillim se Ministria e ka bërë një alokim pa na pyetur, dhe tani shumat që i kemi propozuar duhet që ti korrigjojmë. Sa i përket automjetit të ambulancës duhet me pyet drejtorin e shëndetësisë pse e ka planifikuar 45 mijë euro.

z.Përparim Ramusa; Te planifikimi nuk mundet me qëndruar arsyeja e ngritjes së çmimeve por ka keq-planifikim. E sa i përket pyetjes së parë e arsyetove pse.

znj.Adelina Beqa; Përshëndetje, faleminderit për raportin. Ka disa herë që e kam ngrit çështjen e blerjes së një veture për Qendrën për Punë Sociale. Zyrtarët e QPS-së po rrezikohen në punën e tyre dhe unë mendoj se kjo është më e rëndësishme.

z.Lumni Amrushi; Te Shëndetësia, realisht nuk ka pas se kush planifikon. Ata kanë mbetur pa veturë sepse nuk kanë pas drejtor. Ne nuk e kemi pa kurrë drejtorin e Shëndetësisë dhe prandaj ne ballafaqohemi me këso situatash, dhe nuk planifikohet mirë, e drejtori po mundohet me e arsyetuar.

znj.Adelina Beqa; Më vjen keq nga puntorët e QPS-së që janë të obliguar me shkuar me vetura private për me kry punën zyrtare.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Te çështja e veturave, jo vetëm QKMF-ja por edhe administrata komunale është në gjendje të mjerueshme. Vetura duhet me pas edhe atje edhe këtu. Janë vetëm 5 vetura të vjetruara me të cilat rrezikohen ç' do ditë shoferat edhe zyrtarët.

z.Përparim Ramusa; Fjalimi yt Kryesues ishte jo politik dhe më pëlqen. Mirëpo te administrata nuk ka mbetur puna për shkakë të jo angazhimit, ndërsa te QPS-ja është neglizhencë dhe jo planifikim.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Puna e veturave është problem i përgjithshëm i komunës tonë. Në nivel qendror janë në procedurë. Te QPS-ja është e planifikuar blerja e një veture. Automjeti i ndihmës së shpejtë është prioritet, prandaj ju ftoj që ta miratojmë këtë bartje të mjeteve nga të hyrat për me mundësuar blerjen e veturave.

znj.Zejnije Veliu; Përhëndetje, dmth. brenda këtijë viti QPS-ja ka me marrë veturën. Është mirë që vitin tjetër ta planifikojmë edhe një veturë për QPS-në sepse rastet e dhunës kohët e fundit janë në rritje e sipër.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" me 3 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01/75 për bartjen e të hyrave nga viti 2023 në vitin 2024.**

Pika 4

Rekomandim nga Komisioni për ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" z.Hartmut Ganzke

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Unë e kam pranuar nga Komisioni për ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" një rekomandim për ta shpallur z.Hartmut Ganzke nga Gjermania "Qytetarë Nderi" të Komunës së Shtimes, prandaj edhe kam propozuar që në Kuvend të merr pjesë Kryetari i Komisionit dhe ta bën prezantimin e Rekomandimit.

z.Përparim Ramusa; Në këtë votim unë kamë me "abstenu" sepse unë nuk e njoh biografinë e këtijë z.Hartmut Ganzke, dhe nuk jam i bindur për këtë. Por ta shohim në Kuvend. Propozimi ka ardhur nga Kryetari i Komunës.

z.Lumni Amrushi; Pajtohem me atë që tha doktori. Çmimi është i lartë, ky ndoshta ka dhënë kontribut por ka edhe njerëz tjerë këtu që kanë kontribuar. Unë mendoj se është dashur të fillojmë me ndonjë person tjetër, po mendoj me ndonjë person vendor, kështu që u dashtë me fillu më marë dhe më mirë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Vërtetë keni të drejtë se duhet pasur kujdes se kujt po i epet ky çmim.

z.Kadri Emini; Realisht edhe unë isha pak skeptik, sepse nuk e pashë të arsyeshme që për dy Kamiona me shpallë z.Hartmut Ganzke "Qytetarë Nderi". Por tash me dhënjën e arsyetimit po e shohim pak më ndryshe.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndarjen e çmimit "Qytetar Nderi" për z.Hartmut Ganzke nga shteti i Gjermanisë, me vërejtjen që në seancën e Kuvendit të Komunës më 29.04.2024 të vjen Kryetari i Komisionit dhe të prezanton kontributin e z.Hartmut Ganzke, të dhënë për komunën tonë, po ashtu edhe Kryetari i Komunës me shpalos në Kuvend, biografinë dhe kontributin e zotëri Hartmut Ganzke.**

Pika 5

Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi Komunal të plotësimin të Komisionit për ndarjen e bursave për student

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; DKA- ja ka kërkuar që të miratojmë vendimin për zgjedhjen e dy anëtarëve nga Kuvendi për ta plotësuar Komisionin për ndarjen e bursave për studentë. Hapi diskutimin.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit, për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë, sipas çelësit 1 anëtar nga Pozita dhe 1 anëtar nga Opozita.

Pika 6

Raport pas mbajtjes së dëgjimit publik për draft-planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit 2024-2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Draft-planit të veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në shkolla 2024-2026. Me vërejtjen që në seancën e Kuvendit të Komunës më 29.04.2024 të vjen drejtori dhe ta arsyeton këtë pikë.

Pika 7

Garancioni i NPL-së

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju jeni në dijeni se ne si Kuvend e kemi marrë një vendim për themelimin e një ndërmarrje publike lokale. Tani për ta themeluar këtë ndërmarrje kërkohet një vendim i Kuvendit për një garancion prej 10 mijë euro.

z.Përparim Ramusa; Ne si PDK-ë kemi qenë "kundër" edhe atëherë kur është miratuar ky vendim dhe normalisht që edhe tani për këtë Garancion jemi "kundër".

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për" (4 vota "Për" me votën e dyfishtë të Kryesuesit sipas nenit 48.1 të LVL-së) me 3 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e vendimit për dhënien e Garancionit në shumën prej 10.000€ për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) për Komunën e Shtimes.

Pika 8

Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2024-2026 (pas diskutimit publik).

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Unë në emër të grupit të PDK-së i rekomandojmë Kuvendit për Aprovim.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Planit Lokal të Veprimit (PLV) për komunitetet Rom e Ashkali për periudhën 2024-2026.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 11:22h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

